

## AKT- THEMELIMI

Sot më datë 24/03/1996, Unë Asllan Delip Haxhoi, i dotërlindje 1950, lindur në Mat, banues në lagjen nr.1, Tiranë, me dëshirën time, meqë plotësoj kushtet e parashikuara nga ligji nr.7633 datë 29.11.1995 "Për shoqëritë Tregtare", morra vendim për të krijuar si "Ortak i vetëm" shoqëriën me përgjegjësi të kufizuar "HASTOQI" Shpk.

Qendra e shoqërisë është në lagjen nr.1, përballë Senatatoriumit Tiranë.

Kapitali themelues fillestar është në vlerën 100.000 lekë.

Kohë zgjatje e veprimtarisë sëj është mbi 10 vjetë, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë.

Shoqëria private "HASTOQI" Shpk, është person juridik dhe aktiviteti sëj zhvillohet në përputhje me këtë akt- themelimi e statutin që i bashkëngjitet.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në fushën e tregtisë së me shumicë e pakicë, eksport- import të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, bujqësor, blegtoral, artikuj të ndryshëm të konsumit të gjërë, lëndë të para, karburante e lubrifikante, pajisje e makineri të llojeve të ndryshme, përfshi ato elektrike, elektroshtepijake. Veprimtari tregtare në fushën e ushqimit social, bar- bufe e restorante, hotele e aktivitete turistike. Grumbullim, përpunim e tregtim të produkteve të ndryshme bujqësore, blegtores, bimë medicinale dhe prodhime të të ndryshme të pyllit. Veprimtari në fushën e transportit të ndryshëm të mallrave dhe udhëtarëve, me shërbime tranzitimi në porte e pika kufitare të Shqipërisë, si dhe shitjen e biletave për transporte ndërkombëtare. Prodhim dhe tregtim i materialeve të ndryshme ndërtimore, inerte, blloqe e parafabrikate.

Aktivitet në fushën ndërtimore, si: Kat-1, punime dheu, mureture, betoni, b/orne të zakonshme, punime shëmbjesh.

Kat.2-ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore e tj. dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to.

Kat.3-Punime restaurimi. Kat.17- mirëmbajtje e punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal. Kat.18-studime urbanistike:a)plene rregulluese të qendrave të banimit, studim pjesor urbanistik e plan vendosje të objekteve të veçantë, kryerja e të cilave punime bazohet në licencën 4;0269 datë 03.03.1995 të ministries së Ndërtimit e Turizmit, që i përket ing.ungjellushë Demi, e cila përgjigjet për anën teknike në këtë shoqëri.

Këtë aktivitet, shoqëria do ta zhvilloj si "Ortak i vetëm" me emërtimin "HASTOQI" Shpk.

Akt themelimit mbështetet në kërkesat e ligjit nr.7633 datë

19.11.1996 " Për shoqëritë tregtare " dhe pasi të regjistrohem si person Juridik në organet kompetente, Gjykatë të Rrethit Tiranë e zyrën përkatëse të Tatimeve, do të filloj aktivitetin sipas objektit të parashikuar në statut dhe Vendimin e Gjykatës së rrethit, për regjistrimin si person Juridik të shoqërisë së përgjegjësisë së kufizuar " HASTOQI" Shpk.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit do të përmbahem statutit të hartuar për këtë qëllim, do respektoj dispozitat ligjore në fuqi e ato që do pasojnë, lidhur me ushtrimin e veprimtarisë private në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar " HASTOQI" Shpk.

Shoqëria " HASTOQI" Shpk, drejtohet nga administratori saj që është " Ortaku i vetëm" Aellen Hastoqi.

Ky akt - themelimi, pasi u lexua nënshkruhet rregullisht përpara Noterit Publik.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË " HASTOQI" Shpk.

/ AELLEN HASTOQI /

Nr. 1165 Rep.

Nr. 288 Kol.

REPUBLIKA E SHQËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË.

V E R T E T I M

Sot më datë 23/03/1996 ( nëntëdhjetë e gjashtë), në zyrë të Noterisë Tiranë, para meje Noterit Publik, mu paraqit personalisht Aellen Dalip Hastoqi, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi tij personal, mëdhor me sotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili deklaroi se akti themelimit si më sipër bëhet me vullnetin e tij të plotë e të lirë dhe nënshkruan para meje Noterit Publik dhe, unë Noteri e vertetoj atë.



NOTERI PUBLIK

NOTERE

LEONORA HALILI  
TIRANE ALBANIA  
TEL 343 97

# S T A T U T

## I SHOQËRISË PRIVATE " H A S T O Q I " Shpk.

### E M È R T I M I

#### Neni 1

Formohet shoqëria private " H A S T O Q I " Shpk, eksport - Import, me ortak të vetëm Isllan Dalip Hestoci, i datëlindjes 14.6. 1950, lindur në Mat, banues në lagjen nr.1- Tiranë.

### VEND QENDRIMI

#### Neni 2

Vend qendrimi i shoqërisë " HASTOQI " Shpk, është në lagjen nr. përbellë Senatiumit Tiranë.

Shoqëria, në zhvillimin e aktivitetit të saj, mund të hapë dhe vend qendrimë të tjera, operative, filiale, agjensi në gjithë territorin e vendit, si dhe jashtë Shqipërisë me miratimin e organeve kompetente.

### KOHË ZGJETJA

#### Neni 3

Kohë zgjetja e shoqërisë " HASTOQI " Shpk, është mbi 10 vjet, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

#### Neni 4

Objekti i veprimtarisë ekonomiko financiare është në fushën e tregtimit me shumicë e pakicë, eksport - import të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, bujqësor, blegtoral, artikuj të ndryshëm të konsumit të gjërë, lëndë të para, karburante e lubrifikante, pajisje e makineri të llojeve të ndryshme, përfshi elektronike, elektroshtepijake. Veprimtari tregtare në fushën e ushqimit social, bar- bufe e restorante, hotelewi e aktivitet turistik. Grumbullim, përpunim e tregtim të produkteve të ndryshme bujqësore, blegtorale, bimë medicinale e prodhim të pyllit. Veprimtari në fushën e transportit të ndryshëm të mallrave e udhëtarve, me shërbime transitiimi në porte e pika kufitare të Shqipërisë, si dhe shitjen e biletave për transporte ndërkombëtare. Prodhim, e tregtim i materilave të ndryshme ndërtimore inerte, blloqe e parafabrikate.

Aktivitet në fushën ndërtimore, për projektim e zbatim, si: Kat.1- punime dheu, murature, betoni, b/arme të zakonshme, punime shëmbjesh.

Kat.2-Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore e tj. dhe kompleksi me instalimet e nevojshme për to.

Kat.3- Punime restaurimi.Kat.17- Mirëmbajtje e punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal.

Kat.18- studimet urbane:a)plane rregulluese të qendrave të benimit b)studim pjesor urbanistik,c)plan vendosje të objekteve të veçantë.

Megjithë këtë, shoqëria ka të drejtë të shtojë objektin e veprimtarisë së saj, ose ta pakësoj atë, me vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë.

### KAPITALI I SHOQËRISË

#### Neni 5

Kapiteli themelohet fillestar i shoqërisë " HASTOQI " Shpk, është në vlerën 100.000 lekë, i formuar tërësisht nga Ortaku i vetëm tëllan Hastoqi.

#### Neni 6

Kapiteli i shoqërisë mund të shtohet sipas vendimeve që do të marrë pronari i saj.

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

#### Neni 7

Shoqëria " HASTOQI " Shpk, deklarohet e krijuar, në zbatim të plotë të normave që përmban ky statut dhe ato të legjislaionit Shqiptar në fuqi, ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Ajo fiton zotësi për të vepruar, me regjistrimin e saj si person juridik në Gjykatë të rrethit Tiranë, ndërsa aktivitetin privat me regjistrimin e saj në organet përkatëse financiare të rrethit, ku ajo ka qendërën e saj.

#### Neni 8

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje " shoqëria HASTOQI " Shpk, Eksport - import Tiranë.

#### Neni 9

Shoqëria merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhën nga aktet e administrimit.Ajo përgjigjet për detyrimet kontraktore e jashtëkontraktore brenda kapitalit të saj.Ortaku i vetëm i shoqërisë mbart riskun e veprimtarisë së saj, në nivelin e shumës së mjeteve të investuara.

#### Neni 10

Shoqëria " HASTOQI " Shpk, është pronë e Z. tëllan Hastoqi, themeluesi i saj.Ai merr vendime në zbatim të ligjeve në fuqi dhe sipas këtij statuti, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri.

Zoti tëllan Hastoqi, si pronar i shoqërisë është njëkohësisht dhe administrator i saj.

#### Neni 11

Administratori i shoqërisë, sipas nevojave që paraqiten për zhvillim.

mit e veprimtarisë së shoqërisë, emron administrator dhe punëson punëtor të veprimtarive të ndryshme ekonomike, të përmendura në nenin 4 të këtij statuti.

Zabëthimi i enës teknike në fushën ndërtimore i besohet Ing.Engjell she Demi, e cila është e paisur me Licensën Nr.4.0269 datë 03/3/1995 të Ministrisë së Ndërtimit e Turizmit.

#### Neni 12

Administratori dhe përfaqesuesi i ngarkuar prej tij, janë të veshur me gjithë fuqitë për drejtimin e sekondhëm dhe të jashtësekondhëm të shoqërisë, pa asnjë kufizim. Ata kryejnë gjithë aktet që janë të nevojshme për realizimin e detyrave të saj. Ata kanë të drejtë, midis të tjerave të blejnë e të këmbëjnë pasuri, të lidhen me shoqëritë e tjera vendëse dhe të huaja, brenda e jashtë Shqipërisë. Kanë të drejtë të kryejnë çdo lloj veprimi pranë gjithë shteteve private apo shtetërore, që kanë të bëjnë me garancitë, hipotekat, të kryejnë veprime depositimi pranë institutëve bankare e financiare, kreditime e pagesa, arkëtime e tj.

#### Neni 13

Përfaqesimi i shoqërisë " HASTOQI " Shpk, i përket vetëm administratorit dhe përfaqesuesit të caktuar prej tij. Ata kanë të drejtën e përfaqesimit të shoqërisë në organet gjyqësore e administrative, të caktojnë persona të tjerë me prokurë të posaçme, si dhe socket për qështje në gjykim.

#### MARDHËNIET E PUNËS.

#### Neni 14

Mardhëniat e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për qështje që nuk gjejnë zgjidhje e rregullim në këtë kontratë dhe për raste konfliktesh, zbatohen dispozitetet përkatëse të legjislatcionit Shqiptar në fuqi.

#### Neni 15

Administratori i shoqërisë emron përfaqesuesin, të cilit në aktin emrimit i përcakton detyrën dhe pagën. Po kështu, edhe për punëtorët, shoqëria merr përsipër respektimin e rregullave në fuqi, për punësimin e sigurimet në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 16

Përfaqesuesi nuk mund të marrë cilësinë e ortakut në shoqëri dhe as të ushtrojë aktivitet konkurues të çdo lloji për llogori të tij ose të tërësive, përveç rasteve të autorizuara nga administratori.

#### BILANCI DHE TË ARDHURAT

#### Neni 17

Veprimet ekonomiko - financiare të shoqërisë mbyllet në 31/dhjetor.

të qdo viti. Në fund të qdo periudhe, administratori nxjerr bilancin kontabël të shoqërisë dhe llogarinë fitim humbje, mbështetur në rregullat për mbajtjen e kontabilitetit për subjektet private, të përfaktuara nga organet kompetente të sistemit fiskal.

Bilanci kontabël miratohet nga administratori i shoqërisë, i cili vendos për krijimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin dhe garancinë e veprimtarisë së shoqërisë, fondin e akumulimit, atë rezervë e tj.

**Neni 18**

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve ligjore të përmbushura në nenin 19 dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale nga fitimi, ato i mbeten në përdorim pronarisë të shoqërisë.

**SHPËRBËRJA E SHOQËRISË.**

**Neni 19**

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në qdo kohë dhe për qdo shkak si humbje e kapitalit, pamundësi veprimtarie e tj. Në këtë rast pronari i shoqërisë vendos për mënyrën e likuidimit të saj dhe cakton një ose më shumë likuidatorë, të cilët tregojnë kujdes të veçantë që shoqëria të likujdojë më për detyrimet që u ka personave të tretë fizik e juridik.

**DISPOZITA TË PËRGJITHËSHMË**

**Neni 20**

Për sa nuk shprehet në këtë statut i referohet plotësisht nga pronari i shoqërisë dhe ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare " e ligjeve përkatëse të tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "HASTOÇI" Shpk.**

**/ ASLLAN HASTOÇI /**

REPUBLIKA E SHQËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË.

Nr. 1166 Rep.  
Nr. 299 Kol.

**V E R T E T I M**

Sot më datë 23/03/1996 ( nëntëdhjetë e gjashtë ), në zyrën e Noterisë Tiranë, para meje Noterit Publik, mu paraqit personalisht Asllan Delip Hastoçi, për identitetin e të cilit u sigurove nga letërnjoftimi tij person, mëdhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili deklaroi se statutin si më sipër e bën me vullnetin e tij të plotë e të lirë dhe e nënshkruan para meje Noterit Publik dhe unë Noteri e vertetoj atë.



**NOTERI PUBLIK**

**LEONORA HALILI**  
TIRANE ALBANIA  
TEL 343 97